

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “Grand Class Mobility & Services” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e saj të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 13/11/2024, Themeluesit:

**Znj. Evis Bllaci**, lindur në Tirane, Shqiperi me 17/03/1984, banuese në Tirane, me leternjoftim nr personal **I45317053O**.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

#### Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është

### “Grand Class Mobility& Services” sh.p.k

#### Emri tregtar i shoqërisë: “Grand Class Mobility & Services” SHPK

Në të gjitha aktet dhe dokumentat që dalin nga shoqëria, emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga iniciatlet “SH.P.K”.

#### Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Tiranë, Kashar Yzberisht; Ndërtesë me Nr. Pasurie 245/9 ND1, Zonë Kadastrale 3866, Vol.127, Fq.115, Yzberisht.

#### Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

#### Neni 4- Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

## **1. Automobilistikë Shërbime Transporti & Import- Export**

- Import - Eksport i mjetave motorike, duke përfshirë makina, makineri të rënda (betoniere, vinça, lavatriçe betoni, etj,) dhe makineri industriale dhe çdo lloj mjeti që shërben përmobilitet apo mikro- mobilitet; ushqimeve dhe pijeve alkoolike dhe jo alkoolike; mallrave të konsumit, përfshirë produktet dhe nënproduktet; produkteve te kujdesit personal dhe kozmetik; materialeve të ndërtimit, produkteve të ndërtimit dhe nënprodukteve.
- Shërbimet e marrjes apo dhënies me qira të automjeteve, drejtpërdrejt ose duke furnizuar kompanitë e tjera në treg me automjete ose shërbime.
- Shërbime taksie dhe transporti pasagjerësh apo mallrash.

## **2. Shërbimet e Udhëtimit, Turizmit, Rekrutimit- Burime Njerëzore.**

- Konsulencë udhëtimi dhe funksionimi si tur-operator.
- Shërbimet e rekrutimit të talenteve të fokusuar në industri të tillë si turizmi, mikpritja, prodhimi, punët në fabrikë, fasoneri, ndërtim, e më gjërë, si përklientët vendas ashtu edhe për ata ndërkombëtarë. Rekrutimi bëhet për qëllime punësimi për nevojat e cdo entiteti fizik apo juridik që operon në shqipëri apo jashtë territorit shqiptar.

## **3. Shërbimet e hotelerisë dhe shërbimet (HoReCa)- Hospitality and Retail Services.**

- Ofrimi i shërbimeve të pastrimit dhe mbirimbajties të ambjenteve të brendëshme apo të jashtme;
- Ofrimi i karterisë, lëndës së parë (ushqim & pijë) duke përfshirë si përdorues hotelet, restorantet, kafenetë, kateringun dhe çdo entitet tjetër fizik apo juridik brenda territorit të Shqipërisë.
- Ofrimi i pajisjeve për arredimin e hoteleve, restoranteve.

## **4. Shërbimet e projektimit, ndërtimit, rindërtimit dhe arredimit të njësive të banimit dhe njësive të shërbimit. dhe infrastrukturës.**

## **5. Shërbimet e Telekomunikacionit dhe Internetit,**

- Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve të telekomunikacionit dhe internetit dhe ofrimi i produkteve software dha hardware.

## **6. Prodhimi dhe Tregimi i Energjisë.**

- Studimi, projektimi, zbatimi, prodhimi dhe tregimi i energjisë nga burime të ndryshme duke përfshirë energjinë hidro, hidrogen, gaz natyror, qymyr, erë, fotovoltaik, energji termike dhe çdo lloj forme tjetër energjie.
- Shitje-blerje të energjisë, import dhe eksport energjie brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe furnizim përklientët fundorë.

## **7. Shërbimet e Pasurive të Paluajtshme dhe Pronës & Ndërmjetësimi.**

- Ndërmjetësimi në shitjen, blerjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, së bashku me konsulencën për transaksionet.
- Menaxhimi dhe administrimi i pasurive të paluajtshme dhe pronave të tjera.

Elle

- Ofrimi i Ndërmjetësimit si mekanizëm ligjor në zgjidhien e çështjeve dhe konflikteve penale, civile dhe tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**8.Shërbimet e Çertifikimit të standardeve të ndërtimit sipas ekspertizës që disponohet nga subjekte fizikë apo juridik të liçensuar.**

**9.Ofrimi i konsulencës dhe ofrimi i trajnimeve të certifikuara.**

**10. Hartim dhe/ ose implementim i projekteve kërkimore/ programeve, me vetëfinancim apo finacim nga të tretë.**

**11.Veprimtaria e Përgjithshme e Biznesit.**

- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektivat e saj dhe është në përputhje me ligjet në fuqi.
- Shoqëria ka të drejtë të ndërmarrë çdo veprimtari ligjore të pandaluar nga legjislacioni aktual që mund të përfitojë dhe të çojë përpara qëllimet e shoqërisë.
- Kompania do të operojë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi në Shqipëri dhe juridikSIONET E TJERA KU AJO USHTRON BIZNES.

**Neni 5- Kapitali Themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërise është 2.500.000 (Dy milione e pesqind mijë) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale 2.500.000 (Dy milione e pesqind mijë) lekë.

**Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërise është 2.500.000 (Dy milione e pesqind ) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale 2.500.000 (Dy milione e pesqind mijë) lekë.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht:

**Znj. Evis Bllaci**, lindur në Tiranë, Shqipëri më 17/03/1984, banuese në Tiranë, me leternjoftim Nr personal I45317053O, vlera e kapitalit të përgjithshëm **2.500.000 Lekë**, numri i pjeseve 1, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit te tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

**Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqeritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

#### Neni 8- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.

Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

**Administratori i vetem i shoqërisë është : Znj. Evis Bllaci**, lindur në Tirane, Shqiperi me 17/03/1984, banuese në Tirane, me leternjoftim nr personal I45317053O me afat 5-vjecar, deri më 13/11/2029 .

Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

#### Neni 9- Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### Neni - 10

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve per ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtronen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### Neni - 11

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Tirane , më 13/11/2024.*

## ORTAKËT E SHOQËRISË

Evis Bllaci

*Evis Bllaci  
Ella*